

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E HËNË 5 SHTATOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Adeti e do që në fillim të çdo sesioni të bëhet edhe një fjalë përshëndetëse për kolegët deputetë, por mbi të gjitha edhe për ata të cilët na shohin. Ne zgjodhëm që sot t'i bënim publike të gjitha prioritetet tona, të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, megjithatë, siç e do edhe adeti, do t'i them edhe dy fjalë nga kjo foltore. Është e udhës të thuhet "Puna e mbarë" sa herë që fillon një sesion i ri parlamentar. Megjithatë, çfarë pune të mbarë mund t'i kujtosh këtij parlamenti edhe për sesionin që kaloi?! Punë e mbarë për ligjet e kaluara me shpejtësi?! Punë e mbarë për ligjet e bëra me porosi?! Punë e mbarë për fjalën që i është penguar dhe ndaluar opozitës në mënyrë sistematike?!

Punë e mbarë për kontrollin kushtetues të parlamentit, që asnjëherë nuk u la në hapësirat e Rregullores dhe jo më me mirësjelljen politike që i ka hije një maxhorance?! Jo, "Puna e mbarë" për këto çështje nuk mund të ketë dhe unë nuk besoj, nuk e shpresoj, në fakt, që edhe në këtë sesion të ketë një punë të mbarë të këtij parlamenti, për një arsye fare të thjeshtë: një vit e ca më parë ky parlament ishte produkt i zgjedhjeve të vjedhura, është një fakt, shqiptarët e kanë përjetuar, tashmë edhe i dokumentuar dhe nuk ka sesi të ketë një sjellje të mirë, politikisht korrekte ndaj opozitës në shërbim të shqiptarëve.

Në fakt, po t'i pyesësh sot shqiptarët, askush nuk e sheh këtë parlament dhe këtë sallë si vendin ku flitet për hallet e tyre, për problemet e tyre, për jetën e tyre, për ekonominë e tyre, për familjen e tyre. Jo, dhe nuk shpresoj se mund ta ndryshoj[ sot me këtë fjalë përshëndetëse. Por një gjë do ta them: punë të mbarë dhe jetë të shkurtër këtij parlamenti! Faleminderit!